

VENDIM
Nr. 289, datë 5.6.2024

**MBI MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR PEZULLIMIN DHE NDËRPRERJEN
E MARRËDHËNIES NË SHËRBIMIN CIVIL GJYQËSOR”**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbështetje të nenit 147/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të neneve 67, 68, 80 dhe vijuese të ligjit nr. 98/2016, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes të sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar; si dhe të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, me propozim të Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit,

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullores “Për pezullimin dhe ndërprerjen e marrëdhënies në shërbimin civil gjyqësor”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe hyn në fuqi në datën e botimit në Fletoren Zyrtare.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR
KRYETARE
Naureda Llagami

RREGULLORE
PËR PEZULLIMIN DHE NDËRPRERJEN E MARRËDHËNIES NË SHËRBIMIN CIVIL
GJYQËSOR

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti

Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave më të detajuara lidhur me procedurat e pezullimit nga shërbimi civil gjyqësor për kategoritë e nëpunësve civilë gjyqësorë, si dhe ndërprerjen e marrëdhënies në shërbimin civil gjyqësor.

Neni 2
Përkufizime

Në rregullore termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Ligji për pushtetin gjyqësor” është ligji nr. 98/2016, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”.
2. “Ligji për qeverisjen” është ligji nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”.
3. “Ligji për nëpunësin civil” është ligji nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”.
4. Nëpunësit civilë gjyqësorë janë:
 - a) kancelari;
 - b) këshilltari ligjor në Gjykatën e Lartë;

- c) ndihmësi ligjor në Gjykatën e Apelit;
 - ç) kryesekretari;
 - d) sekretari gjyqësor;
 - dh) nëpunësi i financës dhe i buxhetit;
 - e) nëpunës të tjerë që punojnë në fushat e kërkimit ligjor dhe dokumentacionit, burimeve njerëzore, teknologjisë së informacionit, arkivit dhe marrëdhëniet me publikun, me jashtë ose me median.
5. “Pezullimi” është ndërprerja e përkohshme e marrëdhënies në shërbimin civil gjyqësor.
6. Ndërprerja është përfundimi i marrëdhënies në shërbimin civil gjyqësor në kuptim të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”.

KREU II PEZULLIMI NGA SHËRBIMI CIVIL GJYQËSOR DHE EFEKTET E TIJ

Neni 3

Pezullimi nga shërbimi civil gjyqësor

1. Pezullimi i marrëdhënies në shërbimin civil gjyqësor, bëhet në këto raste:
- a) për shkak të ligjit;
 - b) me kërkesë të nëpunësit civil gjyqësor;
 - c) në rastin e hetimit ose të procedimit disiplinor, kur çmohet e nevojshme.
2. Gjatë periudhës së pezullimit, marrëdhënia e shërbimit civil gjyqësor nuk mund të përfundojë dhe nuk mund të ndryshojë, përveçse me nismën e nëpunësit të pezulluar ose kur parashikohet shprehimisht nga ligji.

Neni 4

Organi kompetent për deklarimin e pezullimit

1. Organi kompetent për deklarimin e pezullimit është:
- a) Këshilli i Lartë Gjyqësor për Kancelarin, Këshilltarin dhe Ndhimësin Ligjor;
 - b) Këshilli i Gjykatës për nëpunësit e tjerë civilë gjyqësorë.

Neni 5

Pezullimi për shkak të ligjit

1. Pezullimi i nëpunësit civil gjyqësor për shkak të ligjit bëhet në këto raste:
- a) emërohet në një nga funksionet e parashikuara në shkronjat “b”, “c” dhe “gj” të nenit 2, të ligjit nr. 152/2013, i ndryshuar, për periudhën përkatëse të emërimit;
 - b) transferohet, për nevoja të institucionit apo shtetit, në një organizatë ndërkombëtare, qeveri të huaj apo në një institucion ndërkombëtar, për periudhën përkatëse;
 - c) kur gjykata vendos ndaj nëpunësit civil gjyqësor si masë ndaluese pezullimin e ushtrimit të detyrës apo shërbimit publik, sipas ligjit në fuqi;
 - ç) deklarohet i zhdukur me vendim të formës së prerë të gjykatës, deri në shfaqjen e personit apo deklarimit të vdekjes me vendim të formës së prerë të gjykatës;
 - d) regjistrohet, sipas ligjit, si kandidat për zgjedhjet vendore apo politike, për periudhën nga regjistrimi deri në shpalljen e rezultatit përfundimtar apo deri në përfundim të mandatit;
 - dh) nëse ndodhet në gjendje konflikti të vazhdueshëm interesi, që deklarohet nga vetë nëpunësi civil gjyqësor, sipas ligjit për parandalimin e konfliktit të interesit, deri në transferimin e tij në një

pozicion tjetër, në përputhje me nenin 52, të ligji nr. 152/2013, i ndryshuar, apo marrjen e masave të tjera për shmangien përfundimtare të konfliktit të interesit nga vetë nëpunësi, sipas afateve të ligjit;

e) në raste të tjera, të parashikuara nga ligji.

2. Eprori direkt dhe çdo nëpunës civil gjyqësor kur ka dijeni për shkaqet e ligjshme të pezullimit sipas pikës 1, të këtij neni, ka detyrimin të njoftojë menjëherë me shkrim Këshillin e Lartë Gjyqësor për Kancelarin, Këshilltarin dhe Ndhimësin Ligjor dhe Këshillin e Gjykatës për nëpunësit e tjerë civilë gjyqësorë.

3. Pezullimi nga shërbimi civil gjyqësor sipas këtij neni, deklarohet pas konstatimit të shkakut të ligjshëm të pezullimit nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, ose Këshilli i Gjykatës.

4. Këshilli i Lartë Gjyqësor ose Këshilli i Gjykatës, pas marrjes dijeni të shkakut të pezullimit sipas ligjit, nis procedurën e verifikimit dhe njofton nëpunësin civil gjyqësor brenda 2 (dy) ditëve nga data e konstatimit të shkakut të ligjshëm të pezullimit.

5. Nëpunësi civil gjyqësor ka të drejtë të dëgjohet nga organi kompetent për deklarimin e pezullimit brenda 3 (tri) ditëve nga data e marrjes së njoftimit.

6. Organi kompetent, pasi dëgjon nëpunësin civil gjyqësor, brenda 2 ditëve, me vendim të arsyetuar, vendos:

a) Deklarimin e pezullimit nga shërbimi civil gjyqësor për rastet e parashikuara në ligj;

b) Mospranimin e kërkesës për pezullim.

7. Vendimi i organit kompetent i njoftohet menjëherë njësisë përgjegjëse pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor për Kancelarët, Këshilltarët dhe Ndhimësit Ligjorë ose Këshillit të Gjykatës për nëpunësit e tjerë civilë gjyqësorë.

Neni 6

Pezullimi me kërkesë

1. Pezullimi me kërkesë të vetë nëpunësit civil gjyqësor bëhet në këto raste dhe në këto afate:

a) kur zhvillon veprimtari në kuadër të organizatave apo të institucioneve ndërkombëtare në raste të tjera nga ato të parashikuara në pikën 6, të nenit 48, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, vërtetuar me dokumentin përkatës të angazhimit në këto veprimtari;

b) për periudha studimi më shumë se 1 (një) muaj deri në 2 (dy) vjet, vërtetuar me dokumentin përkatës të ndjekjes së studimeve;

c) për shkak të një interesi tjetër të ligjshëm, me kërkesë të motivuar për një periudhë deri në 2 (dy) vjet:

i. Për arsye shëndetësore apo të të afërmve, të vërtetuar me dokument të lëshuar nga institucioni shëndetësor brenda ose jashtë vendit;

ii. Për punësim në aktivitet privat/organizata jofitimprurëse brenda ose jashtë vendit, të vërtetuar me kontratën e punës të lidhur me punëdhënësin;

iii. Për punësim në një pozicion të paktën të të njëjtit nivel në një institucion të administratës publike që nuk është pjesë e fushës së veprimit të legjislacionit të nëpunësit civil gjyqësor;

iv. Për punësim në projekte të ndryshme brenda ose jashtë vendit, të vërtetuar me kontratën përkatëse.

2. Pezullimi me kërkesën e nëpunësit civil gjyqësor nuk bëhet në rast se nëpunësi është në periudhë prove sipas ligjit.

3. Kërkesa drejtuar organit kompetent për deklarimin e pezullimit bëhet me shkrim 15 (pesëmbëdhjetë) ditë përpara datës së kërkuar për pezullim. E njëjta procedurë ndiqet edhe kur nëpunësi civil gjyqësor, i pezulluar për një nga rastet e parashikuara në këtë vendim, kërkon të shtyjë afatin e pezullimit për të njëjtin shkak, por jo më shumë se afatet ligjore të parashikuara në ligjin për nëpunësin civil dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij.

4. Konstatimi i pezullimit, sipas pikës 1, shkronjat “a” dhe “b” të këtij neni dhe miratimi i pezullimit, sipas pikës 1, shkronja “c” të këtij neni, bëhet me vendim të:

- a) Këshillit të Lartë Gjyqësor për Kancelarin, Këshilltarin dhe Ndihmësin ligjor;
- b) Këshillit të Gjykatës për nëpunësit e tjerë civilë gjyqësorë.

Neni 7

Pezullimi gjatë procedimit disiplinor

Kur organi përgjegjës vlerëson se vazhdimi i ushtrimit të detyrës nga nëpunësi civil gjyqësor, ndaj të cilit ka filluar një procedim disiplinor, pengon hetimin administrativ apo mund të cenojë ushtrimin e përshtatshëm të detyrës së tij, mund të vendosë pezullimin e nëpunësit civil gjyqësor deri në marrjen e vendimit përfundimtar.

Neni 8

Efektet e pezullimit

1. Në përfundim të afatit të pezullimit apo të zhdukjes së shkakut të pezullimit, përveçse kur vendoset përfundimi i marrëdhënies së shërbimit civil gjyqësor, nëpunësi civil gjyqësor rikthehet në pozicionin e mëparshëm të punës ose në rast se pozicioni i mëparshëm është i plotësuar përfundimisht, ai transferohet në një vend tjetër të së njëjtës kategori. Në rast se kjo është e pamundur, nëpunësit regjistrohen në një listë, e cila administrohet nga njësia përgjegjëse. Ata qëndrojnë në këtë listë deri në sistemimin e tyre në një pozicion të rregullt në shërbimin civil gjyqësor.

2. Njësia përgjegjëse është e detyruar që në momentin e krijimit të një vendi të lirë në shërbimin civil gjyqësor, t’ia ofrojë fillimisht nëpunësve civilë gjyqësorë të regjistruar në listë, sipas pikës 1 të këtij neni, që plotësojnë kriteret përkatëse, duke respektuar rregullat për transferimin të parashikuara nga ligji për pushtetin gjyqësor.

3. Këta nëpunës civilë gjyqësorë mund të emërohen përkohësisht me pëlqimin e tyre edhe për plotësimin e vendeve të lira, të krijuara në mënyrë të përkohshme. Njësia përgjegjëse në këtë rast bën emërimin e përkohshëm të këtyre nëpunësve.

4. Në rastin e pezullimit për një afat deri në 3 (tre) muaj, pozicioni i mëparshëm i punës nuk plotësohet deri në përfundimin e pezullimit.

5. Periudha e pezullimit, në rastet e parashikuara nga neni 5, pika 1, shkronjat “a”, “b” dhe “dh”, neni 6, pika 1, shkronja “a” dhe nga neni 8, pika 6, shkronja “a/i” të kësaj rregulloreje, llogaritet si vjetërsi në shërbimin civil gjyqësor.

6. Nëpunësi civil gjyqësor nuk përfiton pagë gjatë periudhës së pezullimit. Përfundim nga kjo rregull bëjnë rastet e mëposhtme:

a) Nëpunësi civil gjyqësor i pezulluar përfiton 50 (pesëdhjetë) për qind të pagës së plotë përveç shtesës për kushte pune vetëm në këto raste:

- i. në rastin e procedimit disiplinor sipas pikës 6, të nenit 59, të ligjit nr. 152/2013, i ndryshuar
- ii. nëse krijohet një situatë e vazhdueshme konflikti interesi që deklarohet në kohën dhe mënyrën e duhur, sipas ligjit për parandalimin e konfliktit të interesave, deri në transferimin përfundimtar në një pozicion tjetër;

b) Nëpunësi civil gjyqësor i pezulluar përfiton pagë të plotë, përveç shtesës për kushte pune vetëm:
i. kur gjykata vendos ndaj nëpunësit civil, si masë ndaluese pezullimin e ushtrimit të detyrës apo shërbimit publik, sipas ligjit në fuqi;

7. Nëpunësi civil gjyqësor duhet të kthejë shumën prej 50 për qind të pagës së përfituar gjatë periudhës së pezullimit, bazuar në një procedurë disiplinore ose penale, në rastet kur:

- a) është larguar nga detyra me vendim përfundimtar, në kuadër të procedimit disiplinor përkatës;

b) është shpallur fajtor për kryerjen e një vepre penale në çështjen përkatëse, me vendim përfundimtar.

KREU III PËRFUNDIMI I PERIUdhËS SË PEZULLIMIT

Neni 9

Përfundimi i periudhës së pezullimit

1. Në rastet e pezullimit për një afat deri në 3 (tre) muaj, nëpunësi civil gjyqësor njofton organin kompetent që ka deklaruar pezullimin, për përfundimin e pezullimit dhe rikthimin në detyrë, jo më vonë se 7 (shtatë) ditë kalendarike përpara datës së përfundimit të afatit të pezullimit. E njëjta procedurë ndiqet edhe në rastet kur nëpunësi civil gjyqësor do të ndërpresë periudhën e pezullimit më shpejt se afati për të cilin është miratuar pezullimi. Në përfundimin e periudhës së pezullimit, nëpunësi civil gjyqësor që ka qenë i pezulluar për një afat deri në 3 (tre) muaj, rikthehet në pozicionin e mëparshëm të punës.

2. Në përfundim të periudhës së pezullimit për rastet e pezullimit për një afat më të gjatë se 3 muaj, nëpunësi civil gjyqësor njofton organin kompetent që ka deklaruar, për përfundimin e pezullimit jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë kalendarike përpara datës së përfundimit të afatit të pezullimit. E njëjta procedurë ndiqet edhe në rastet kur nëpunësi civil gjyqësor ndërpret periudhën e pezullimit më shpejt se afati për të cilin i është miratuar pezullimi.

3. Kryetari i Gjykatës, brenda 3 (tri) ditëve kalendarike nga momenti i marrjes dijeni për rikthimin në punë të nëpunësit civil gjyqësor, njofton me shkrim:

- a) Këshillin e Lartë Gjyqësor për Kancelarin, Këshilltarin dhe Ndihmësin Ligjor;
- b) Këshillin e Gjykatës për nëpunësit e tjerë civilë gjyqësorë.

4. Në rast se nëpunësi civil gjyqësor, i pezulluar për një afat më të gjatë se 3 (tre) muaj, nuk respekton afatin e njoftimit sipas përcaktimit në pikën 2, të këtij neni, dhe njoftimi nuk është kryer deri në ditën e përfundimit të afatit të pezullimit, organi kompetent për deklarimin e pezullimit, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve kalendarike nga dita e përfundimit të afatit të pezullimit i kërkon atij me shkrim të shprehet lidhur me vijimësinë e marrëdhënies në shërbimin civil gjyqësor.

Neni 10

Rikthimi në punë pas përfundimit të afatit të pezullimit

1. Organi kompetent për deklarimin e pezullimit, brenda 10 (dhjetë) ditëve kalendarike nga data e marrjes së njoftimit për rikthimin në punë, vendos:

- a) rikthimin e nëpunësit civil gjyqësor në pozicionin e mëparshëm të punës, duke nxjerrë edhe aktin e rikthimit;
- b) transferimin në një pozicion tjetër të së njëjtës kategori, nëse pozicioni i mëparshëm i punës është plotësuar sipas procedurave të parashikuara në ligj;
- c) regjistrimin e nëpunësit civil gjyqësor në listë, duke e njoftuar atë për regjistrimin dhe arsyet e pamundësisë së zbatimit të procedurës së parashikuar në shkronjat “a” dhe “b”, të kësaj pike të vendimit.

2. Në momentin e krijimit të një vendi të lirë në shërbimin civil gjyqësor organi kompetent sipas ligjit është i detyruar të nxjerrë aktin e transferimit në këtë pozicion për njërin nga nëpunësit e regjistruar në listë dhe që plotëson kriteret përkatëse të vendit vakant. Transferimi në atë pozicion bëhet me precedencë sipas kësaj renditjeje:

- a) Nëpunësi me kohëzgjatje më të madhe të qëndrimit në listë;

b) Nëse ka më shumë se 1 nëpunës me të njëjtën kohëzgjatje të qëndrimit në listë, nëpunësi me vjetërsi më të madhe në shërbimin civil gjyqësor;

c) Nëse ka më shumë se 1 nëpunës civil gjyqësor me të njëjtën vjetërsi në shërbimin civil gjyqësor, nëpunësi me më shumë vlerësime pozitive të rezultateve në punë si nëpunës civil gjyqësor.

3. Nëpunësi civil gjyqësor për të cilin organi kompetent sipas ligjit ka nxjerrë aktin e transferimit, ka të drejtë të refuzojë transferimin vetëm për shkaqet e mëposhtme:

a) kur gjendja e tij shëndetësore, provuar me vërtetim mjekësor, e bën transferimin të pamundur;

b) nëse vendi ku transferohet gjendet më shumë se 45 km nga vendbanimi i nëpunësit civil gjyqësor.

4. Refuzimi i transferimit për arsye të tjera, përveç pikës 3 të këtij neni, përbën shkak për ndërprerjen e marrëdhënieve nga shërbimi civil gjyqësor.

SEKSIONI II NDËRPRERJA E MARRËDHËNIES NË SHËRBIMIN CIVIL GJYQËSOR

KREU I

Neni 11

Ndërprerja e marrëdhënieve në shërbimin civil gjyqësor

Marrëdhënia në shërbimin civil gjyqësor ndërpritet nëpërmjet:

a) lirimit nga shërbimi civil gjyqësor;

b) largimit nga shërbimi civil gjyqësor, si masë disiplinore;

c) për shkak të ligjit.

Neni 12

Organet kompetente për ndërprerjen e marrëdhënieve në shërbimin civil gjyqësor

1. Marrëdhënia e shërbimit civil gjyqësor ndërpritet me vendim të:

a) Këshillit të Lartë Gjyqësor për Kancelarin, Këshilltarin dhe Ndihmësin Ligjor;

b) Këshillit të Gjykatës, ku nëpunësit e tjerë civilë gjyqësorë ushtrojnë funksionin.

2. Këshilli i Gjykatës njofton Këshillin e Lartë Gjyqësor për vendimin e ndërprerjes së marrëdhënieve në shërbimin civil gjyqësor të nëpunësve, brenda 3 (tri) ditëve nga data e marrjes së vendimit.

Neni 13

Lirimi nga shërbimi civil gjyqësor

1. Marrëdhënia në shërbimin civil gjyqësor përfundon nëpërmjet lirimit në këto raste:

a) për shkak të refuzimit të pajustificuar të nëpunësit civil gjyqësor për të pranuar transferimin e përhershëm;

b) si rezultat i ristrukturimit të gjykatës;

c) kur nëpunësi civil gjyqësor deklarohet i paaftë për punë nga komisioni kompetent mjekësor, sipas ligjit;

d) pas dy vlerësimeve “jo kënaqshëm” të rezultateve në punë;

e) kur nëpunësi civil gjyqësor ushtron të drejtën për pensionin e parakohshëm të pleqërisë, sipas ligjit;

f) kur nëpunësi civil gjyqësor gjendet në një situatë të konfliktit të vazhdueshëm të interesit, të deklaruar nga vetë nëpunësi dhe sipas ligjit, nuk merr masat e parashikuara për shmangien e konfliktit

të interesit brenda afatit të përcaktuar apo nëse transferimi në një pozicion tjetër nuk do të mënjanonte gjendjen e konfliktit të vazhdueshëm të interesit;

g) kur nëpunësi jep dorëheqjen nga detyra;

h) kur kancelari, këshilltari, ndihmësi ligjor anëtarësohet në një parti politike ose kur nëpunësit e tjerë civilë gjyqësorë bëhen anëtarë të organeve drejtuese të një partie politike;

i) në çdo rast tjetër, të parashikuar nga ligji.

2. Nëpunësit civil gjyqësor i ndërpritet marrëdhënia nga shërbimi civil gjyqësor sipas shkronjës “c” të pikës 1 të këtij neni kur bëhet i paaftë për 2 (dy) vjet radhazi të pandërprerë për të kryer detyrat për shkak të gjendjes shëndetësore. Paaftësia shëndetësore konstatohet nga organet kompetente, sipas rastit, në bazë të vërtetimit të lëshuar nga KMCAP-ja. Nëpunësi civil gjyqësor paraqet pranë organit kompetent dokumentin e shëndetit në punë, sipas legjislacionit në fuqi për sigurinë dhe shëndetin në punë, brenda datës 10 janar të çdo viti.

3. Ndërprerja e marrëdhënieve nga shërbimi civil gjyqësor sipas shkronjës “d” të pikës 1 të këtij neni, bëhet menjëherë pas dy vlerësimeve negative radhazi nga organet kompetente, sipas rastit. dhe i njoftohet menjëherë nëpunësit civil gjyqësor. Vlerësim negativ konsiderohet vlerësimi “jo kënaqshëm”.

Neni 14

Ndërprerja e marrëdhënieve për shkak të ristrukturimit të gjykatës

1. Kur në rastet e ristrukturimit të gjykatës, ka shkurtim të numrit të përgjithshëm të pozicioneve dhe transferimi i nëpunësve civilë gjyqësorë sipas ligjit është i pamundur, organi kompetent deklaron me vendim ndërprerjen e marrëdhënieve nga shërbimi civil gjyqësor, bazuar në njoftimin e njësisë apo strukturës përkatëse të ngritur për ristrukturimin.

2. Nëpunësit civilë gjyqësorë që i përkasin gjykatës që ristrukturohet njoftohen 1 muaj përpara për fillimin e kësaj procedure dhe në rastin e parashikuar nga pika 1 e këtij neni, nëpunësi civil gjyqësor që largohet ka të drejtën e një dëmshpërblimi, në përputhje me vjetërsinë e tij në punë, sipas rasteve të mëposhtme:

a) deri në 1 vit eksperiencë pune si nëpunës civil gjyqësor, paga e 1 muaji;

b) nga 1–3 vjet eksperiencë pune si nëpunës civil gjyqësor, paga e 3 muajve;

c) nga 3–6 vjet eksperiencë pune si nëpunës civil gjyqësor, paga e 6 muajve;

ç) nga 6–9 vjet eksperiencë pune si nëpunës civil gjyqësor, paga e 9 muajve;

d) mbi 9 vjet eksperiencë pune si nëpunës civil gjyqësor, paga e 12 muajve.

3. Nëpunësit civilë gjyqësorë, të cilët janë larguar nga shërbimi civil gjyqësor si pasojë e ristrukturimit apo e mbylljes së gjykatës, kanë të drejtë që brenda periudhës 2-vjeçare pas përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil gjyqësor:

a) të konkurrojnë si nëpunës civilë gjyqësorë për procedurat e lëvizjes paralele apo të ngritjes në detyrë;

b) të emërohen në mënyrë të përkohshme nga njësia përgjegjëse, me pëlqimin e tyre, në pozicione të shërbimit civil gjyqësor.

Neni 15

Ndërprerja e marrëdhënieve për shkak të paftësisë për punë

1. Organi kompetent, sipas rastit, me marrjen dijani për pamundësinë fizike dhe mendore të nëpunësit civil gjyqësor, heton rastet të cilat çojnë në largimin nga funksioni ose pezullimin e përkohshëm të nëpunësit civil gjyqësor.

2. Nëpunësi civil gjyqësor lirohet nga shërbimi civil gjyqësor kur bëhet i paaftë për 2 (dy) vjet radhazi të pandërprerë për të kryer detyrat për shkak të gjendjes shëndetësore. Paaftësia shëndetësore dokumentohet nga njësisia e burimeve njerëzore, në bazë të vërtetimit të lëshuar nga KMCAP-ja.

3. Nëpunësi civil gjyqësor ka të drejtë të ketë akses në dosje, të përfaqësohet nga përfaqësuesi i tij dhe të dëgjohet.

4. Organi kompetent vendos pezullimin përkohësisht ose përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil gjyqësor, nëse arrin në përfundimin se kushtet fizike dhe mendore të nëpunësit civil gjyqësor e bëjnë atë përkohësisht ose përgjithmonë të papërshtatshëm për funksionin.

Neni 16

Ndërprerja e marrëdhënies për shkak të dorëheqjes

1. Nëpunësi civil gjyqësor mund të njoftojë përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil gjyqësor nëpërmjet paraqitjes së dorëheqjes me shkrim te Këshilli i Lartë Gjyqësor për Kancelarët, Këshilltarët dhe Ndihmësit Ligjor dhe te Këshilli i Gjykatës për nëpunësit e tjerë.

2. Dorëheqja nuk motivohet dhe i prodhon efektet 30 (tridhjetë) ditë nga data e paraqitjes së saj.

3. Në raste të justifikuara, me kërkesë të motivuar të nëpunësit civil gjyqësor dhe me miratimin e organeve kompetente të përcaktuar sipas pikës 1, të këtij neni, dorëheqja i prodhon efektet përpara afatit 30-ditor nga njoftimi.

4. Nëpunësit civilë gjyqësorë, të cilët janë larguar nga shërbimi civil gjyqësor si pasojë e dorëheqjes, kanë të drejtë që të konkurrojnë si nëpunës civilë gjyqësorë për procedurat e lëvizjes paralele apo ngritjes në detyrë, sipas ligjit “Për nëpunësit civilë”, deri në 2 (dy) vjet pas përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil gjyqësor.

Neni 17

Largimi nga shërbimi civil gjyqësor

Largimi nga shërbimi civil gjyqësor jepet si masë disiplinore vetëm për shkelje shumë të rënda të nëpunësit civil gjyqësor, sipas rregullave dhe procedurave të parashikuara në ligjin “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve”, si dhe në rregulloren “Për procedurën disiplinore në shërbimin civil gjyqësor”.

Neni 18

Ndërprerja e marrëdhënies në shërbimin civil gjyqësor për shkak të ligjit

1. Marrëdhënia në shërbimin civil gjyqësor përfundon për shkak të ligjit, kur:

- a) nëpunësi vdes apo kur merr formë të prerë vendimi për deklarimin e vdekjes së tij;
- b) nëpunësi humbet shtetësinë shqiptare apo merr formë të prerë vendimi i gjykatës për kufizimin apo heqjen e zotësisë për të vepruar;
- c) plotësohet mosha për pensionin e plotë të pleqërisë, sipas ligjit për sigurimet shoqërore;
- d) konstatohet pavlefshmëria e aktit të emërimit, që nuk sjell asnjë pasojë juridike, si dhe konsiderohet se nuk ekziston;
- e) dënohet me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale.

2. Përfundimi i marrëdhënies në shërbimin civil gjyqësor, për shkak të ligjit, konstatohet 5 (pesë) ditë nga ndodhja apo njohja e tij nga njësisia e burimeve njerëzore të institucionit, ku nëpunësi ushtron detyrën, të cilët duhet të njoftojnë menjëherë organet kompetente, sipas rastit, për ndërprerjen e marrëdhënies në shërbimin civil gjyqësor.

3. Organet kompetente, sipas rastit, deklarojnë përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil gjyqësor, jo më vonë se 2 (dy) javë nga marrja e njoftimit për shkakun e përfundimit.

Neni 19

Njoftimi i vendimit për ndërprerjen e marrëdhënies në shërbimin civil gjyqësor dhe efektet e tij

1. Organi kompetent deklaron ndërprerjen e marrëdhënies nga shërbimi civil gjyqësor të nëpunësit civil gjyqësor me vendim të arsyetuar, që i njoftohet nëpunësit brenda 3 (tri) ditëve nga data e marrjes së vendimit.

2. Nëpunësi civil gjyqësor që largohet nga shërbimi civil gjyqësor merr masa për dorëzimin e detyrës në mënyrë korrekte dhe në përputhje me etikën e nëpunësit civil gjyqësor.

3. Nëpunësi civil gjyqësor dorëzon tek eprori direkt dokumentacionin që zotëron, për shkak të detyrës, si dhe bashkëpunon me njësinë përgjegjëse/kancelarin për mbajtjen e inventarit fizik, dorëzimin e pajisjeve dhe të mjeteve të punës në inventar.

4. Dorëzimi i detyrës, i dokumentacionit, i pajisjeve dhe i mjeteve të punës në inventar bëhet, si rregull, brenda 5 (pesë) ditëve nga data e marrjes së vendimit të ndërprerjes së marrëdhënies në shërbimin civil gjyqësor. Në raste të veçanta, me urdhër të eprorit direkt, ky afat mund të zgjatet edhe me 5 (pesë) ditë të tjera.

SEKSIONI III

E DREJTA E ANKIMIT DHE RIKTHIMI NË DETYRË

Neni 20

E drejta e ankimit

1. Nëpunësi civil gjyqësor ka të drejtën e ankimit ndaj vendimeve të Këshillit të Gjykatës, në lidhje me pezullimin apo ndërprerjen e marrëdhënies në shërbimin civil gjyqësor, brenda 45 (dyzet e pesë) ditëve nga marrja e vendimit, pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë.

2. Nëpunësi civil gjyqësor ka të drejtën e ankimit ndaj vendimeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, në lidhje me pezullimin apo ndërprerjen e marrëdhënies në shërbimin civil gjyqësor, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga marrja e vendimit, pranë Gjykatës Administrative të Apelit.

Neni 21

Rikthimi në detyrë me vendim gjykate

1. Vendimet gjyqësore të formës së prerë për rikthimin e nëpunësve civilë gjyqësorë në detyrë zbatohen menjëherë nga organi kompetent, sipas rastit.

2. Nëse rikthimi i nëpunësve civilë gjyqësorë në detyrë, sipas pikës 1 të këtij neni, është objektivisht i pamundur, atëherë ata regjistrohen në një listë pritjeje deri në sistemimin e tyre në një pozicion të rregullt në shërbimin civil gjyqësor. Lista administrohet nga njësia përgjegjëse.

3. Gjatë kohës së qëndrimit në listë, nëpunësit civilë gjyqësorë paguhen sipas pozicionit të fundit që kanë pasur në shërbimin civil.

4. Organi kompetent, sipas rastit, është i detyruar që në momentin e krijimit të një vendi të lirë në shërbimin civil gjyqësor, të emërojë fillimisht me pëlqimin e tyre, nëpunësit civilë gjyqësorë të regjistruar në listë, sipas kategorisë përkatëse dhe që plotësojnë kriteret e pozicionit të punës.

5. Këta nëpunës, me pëlqimin e tyre, mund të sistemohen edhe për plotësimin e vendeve të lira, të krijuara në mënyrë të përkohshme. Organi kompetent, sipas rastit, në këtë rast bën emërimin e përkohshëm të këtyre nëpunësve.

Neni 22

Dispozita të fundit

Dispozitat e “Ligjit për nëpunësin civil” dhe aktet nënligjore normative të nxjerra në bazë të tij, zbatohen edhe për nëpunësit civilë gjyqësorë, për aq sa nuk bien ndesh me parashikimet e ligjit “Për organizimin e pushtetit gjyqësor” dhe parashikimet e këtij vendimi.

Neni 23

Hyrja në fuqi

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.